



Narcotics Anonymous

Çfarë është programi I Narkomanët Anonimë?

NA është një bashkësi ose shoqëri jofitimprurëse burrash dhe grash për të cilët droga ishte bërë një problem i madh. Ne jemi të varur në rikuperim që takohemi rregullisht për të ndihmuar njëri-tjetrin të qëndrojmë të pastër. Ky është një program i abstinencës së plotë nga të gjitha drogat. Ekziston vetëm një kërkesë për anëtarësim: dëshira për të ndaluar përdorimin. Ne sugjerojmë që të mbani një mendje të hapur dhe t'i jepni vetes një mundësi. Programi ynë është një grup parimesh të shkruara aq thjesht sa mund t'i ndjekim në jetën tonë të përditshme. Gjëja më e rëndësishme është se ato funksionojnë.

Nuk ka asnjë detyrim në NA. Ne nuk jemi të lidhur me asnjë organizatë tjetër. Nuk kemi tarifa regjistrimi apo kuota, nuk ka zotime për të nënshkruar dhe as premtime për t'i bërë dikujt. Ne nuk jemi të lidhur me asnjë grup politik, fetar apo të zbatimit të ligjit, dhe nuk jemi nën mbikëqyrje në asnjë moment. Çdokush mund të bashkohet me ne, pavarësisht moshës, racës, identitetit seksual, bindjeve, fees apo mungesës së fesë.

Nuk na intereson çfarë apo sa shumë keni përdorur, kush kanë qenë lidhjet tuaja, çfarë keni bërë në të kaluarën, cila është gjëndja juaj ekonomike, por vetëm për atë që doni të bëni lidhur me problemin tuaj dhe si mund të ndihmojmë. I sapoardhuri është personi më i rëndësishëm në çdo takim, sepse ne mund ta ruajmë atë që kemi vetëm duke e ndarë me të tjerët. Nga përvoja jonë në grup kemi mësuar se ata që vazhdojnë të vijnë rregullisht në takimet tona, qëndrojnë të pastër.